

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7848
E martë, 30 korrik 2024
Çmimi 0.50

Kurti ua rikujton sërish mërgimtarëve se është hapur Dritarja për Investime të Diasporës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

EDHE 10 DITË PËR KONVERTIM TË PATENTSHOFERËVE PËR SERBËT E KOSOVËS: ÇFARË PASTAJ?



Policia e Kosovës ka bërë të ditur se nuk do t'i "tolerojë" më ato patenta që u jepen serbëve me banim në Kosovë, pas

skadimit të afatit për pajisjen e tyre me patentë shoferë të Kosovës. Pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë kanë edhe

dhjetë ditë afat për t'i konvertuar patentshoferët e tyre, që janë lëshuar nga autoritetet serbe në ato të autoriteteve të Kosovës


104 KADETË TË FSK-së JANË DUKE STUDIAR NË AKADEMITË USHTARAKE TË BOTËS



KOZ-ja PREZANTON DISA RASTE TË FLETËVOTIMEVE TË VLEFSHME DHE TË PAVLEFSHME NË ZGJEDHJET PËR KUVEND



AKTUALE



HOVENIER E PREZANTON ZËVENDËSSHEFEN E RE TË MISIONIT NË AMBASADËN E SHBA-së

DARDAN KRIVQAQ DËNOHET ME BURGIM TË PËRJETSHËM PËR VRASJEN E MARIGONA OSMANIT

POLICIA NË RAJONIN E MITROVICËS SË JUGUT REALIZON KONTROLLE TË JASHTËZAKONSHME

EKONOMI



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR FINANCIMIN E MAGJISTRALËS "PRISHTINË - MITROVICË" ME VLERË 13 MILIONË EURO

ASETET E FONDEVE PENSIONALE KANË ARRITUR VLERËN 2.94 MILIARDË EURO

SPORT



AKILI DHE NORA ELIMINOHEN NGA LOJËRAT OLIMPIKE

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Iniciativa për Akademinë Shqiptare lëkund Qeverinë maqedonase

SHKUP, 29 KORRIK - Tridhjetë e gjashtë ditë nga krijimi zyrtar i koalicionit të ri qeverisë maqedonase dolën në sipërfaqe mosmarrëveshjet e para publike mes partnerëve VMRO-DPMNE, ZNAM dhe VLEN.

Ata thonë se nuk kanë mosmarrëveshje, ndërsa lideri i ZNAM-it, Maksim Dimitrievski, paralajmëroi se këto ditë do të dalë me qëndrim për marrëdhëniet në qeveri.

Analistët politikë presin që një mospërputhje e tillë e partnerëve të qeverisë të kthehet në një dukuri normale.

Temat e punësimit, sipas çelësit etnik, dhe njoftimi për krijimin e një Akademie Shqiptare të Shkencave dhe Arteve në Maqedoninë e Veriut, që ndezi pasionet partiake këtë fundjavë, treguan mosmarrëveshjet e para mes partnerëve qeveritarë.

Llogaritjet e reja të të ashtuquajturit balancues – sipas të cilit përfaqësimi i drejtë në institucione llogaritet në bazë të përqindjes së popullsisë rezidente në shtet nga regjistrimi i vitit 2021, dhe jo si më parë,

sipas përqindjes së përkatësisë etnike në totalin e popullsisë së regjistruar – kanë penguar 115 institucione të marrin “dritën jeshile” për punësim në administratën publike.

Ky ishte problemi i parë mes partnerëve të koalicionit, ZNAM-it të Maksim Dimitrievskit dhe koalicionit shqiptar VLEN.

Rasti i dytë ishte shpallja e mbështetjes së VLEN-it për iniciativën e katër komunave për themelimin e Akademisë Shqiptare të Shkencave dhe Arteve, gjë që u kundërshtua nga partnerët e koalicionit VMRO-DPMNE dhe ZNAM, si dhe nga anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe Arteve.

Sipas VMRO-DPMNE-së dhe VLEN-it, korrespondenca publike mes tyre për këto dy tema nuk paraqet problem në funksionimin e koalicionit, ndërsa për analistët politikë kjo është tregues i qartë i keqkuptimeve të brendshme që mund të shndërrohen në problem më serioz.

Koalicioni qeverisës “Maqedonia juaj”, i udhëhequr nga VMRO-



DPMNE, thotë se marrëdhëniet e koalicionit janë stabile. Kryeministri Hristijan Mickoski, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, theksoi se partia e tij ka bashkëpunim parimor me partnerët e koalicionit.

Ai ndan të njëjtin qëndrim për marrëdhëniet mes VLEN-it dhe ZNAM-it, të cilat në disa raste gjatë muajit të kaluar kanë dalë me qëndrime të ndryshme për disa çështje.

Mickoski thotë se partnerët

qeveritarë nuk duhet të bien dakord për gjithçka, por çelësi është të pajtohen për shumicën e gjërave. “Kur je në një familje në shtëpi, jo gjithmonë shkon mirë me anëtarët e një familjeje, në momente të caktuara do të hasësh keqkuptime, por në një dialog, një mjedis miqësor demokratik duhet t'i kapërcesh. Deri më tani në këto pesë javë, kështu funksionojmë si koalicion”, tha kryeministri Mickoski.

Me qëndrim të ngjashëm në opinion ka dalë edhe lideri i njërës prej partive në koalicionin VLEN, Izet Mexhiti, i cili e ka bindur opinionin se në tre dekadat e fundit nuk ka pasur koalicion më të qëndrueshëm se ky. “Mendoj se ky është koalicioni më i qëndrueshëm në historinë e Maqedonisë së Veriut. Ai ka 78 deputetë, me tendencë për të kaluar 80 deputetë. Natyrisht, ne jemi parti të ndryshme, me mendime të ndryshme. Unë bëj thirrje që ato të debatohen dhe të zgjidhen brenda qeverisë, dhe jo me deklarata për media”, ka vlerësuar Mexhiti.

Por, nga Lëvizja ZNAM thonë se për momentin nuk do të komentojnë publikisht marrëdhëniet mes partnerëve të tyre në pushtet, VMRO-DPMNE-së dhe VLEN-it.

Lideri i Lëvizjes, Maksim Dimitrievski, tha shkurt për Radion Evropë e Lirë se së shpejti do të mbajë konferencë për media, ku do të përgjigjet në pyetjet për marrëdhëniet në koalicion.

Ukraina i vazhdon sulmet kundër objekteve infrastrukturore në Rusi

KIEV, 29 KORRIK - Ukraina kreu një valë sulmesh me dronë thellë brenda territorit të Rusisë mëngjesin e së hënës, duke i dëmtuar objektet e infrastrukturës në dy rajone, thanë Ministria e Mbrojtjes e Rusisë dhe zyrtarët rajonalë.

Një ditë më parë, një sulm i raportuar ukrainas shkaktoi zjarr në një rafineri naftë në Rusi.

Në rajonin perëndimor të Rusisë, Oryol, një termocentral u dëmtua pasi u godit nga copëzat e dy dronëve të rrëzuar ukrainas mbi qarkun Glazunovski, tha guvernatori rajonal Andrey Klychov, në Telegram. “Shërbimet emergjente janë duke u marrë me pasojat e sulmit ajror, ndërsa agjencitë për sundim të ligjit janë në



vendin e ngjarjes”, shkroi Klychov, pa shpjeguar se çfarë dëmsh ka pësuar termocentrali.

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se mbrojtja e saj ajrore i shkatërroi 39 dronë ukrainas, prej të cilëve: 19

mbi rajonin Kurks, 9 në Belgorod, 3 në Voronezh, 5 në Bryansk dhe 3 mbi rajonin Leningard.

Pretendimet e Rusisë nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur. Kjo është dita e dytë radhazi që

sulmet e raportuara ukrainase shkaktajnë dëme në objektet e infrastrukturës ruse.

Më 28 korrik, u raportua se dronët e ushtrisë ukrainase goditën një depo naftë në rajonin Kurks. Video të postuara online shfaqën një zjarr të madh në të. Guvernatori rajonal, Aleksei Smimov, tha se tri cisterna naftë u përfshinë nga zjarri si pasojë e sulmeve me dronë.

Prej se e nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 2022, Moskë vazhdimisht dhe sistematikisht i ka goditur objektet infrastrukturore dhe civile në Ukrainë, duke shkaktuar viktima dhe dëme.

Si përgjigje, Ukraina ka filluar t'i godasë objektet e rafinerisë së naftës dhe infrastrukturën

energjetike brenda Rusisë, të cilat kryesisht punojnë për ushtrinë ruse. Më 27 korrik, Ukrayinska Pravda raportoi se dronët ukrainas goditën një rafineri naftë në rajonin Riazan të Rusisë.

Ndërkohë, Rusia kreu sulme në qytetet jugore të Ukrainës, Herson dhe Nikopol, mëngjesin e së hënës, duke i plagosur 20 persona, përfshirë pesë fëmijë, thanë zyrtarët rajonalë dhe lokalë.

Kundërajorët ukrainas i rrëzuan një raketë dhe nëntë dronë rusë mbi rajonet e saj të hënës, tha komandanti i Forcës Ajrore të Ukrainës, Mykola Oleshchuk.

Bombardimet e vazhdueshme i kanë detyruar qindra civilë të ikin nga kjo zonë, thanë zyrtarët lokalë për Radion Evropë e Lirë.

Së paku 8 të plagosur në një sulm me thikë në Angli

LONDËR, 29 KORRIK - Shërbimi emergjent britanik njoftoi se është arrestuar një burrë, pasi së paku tetë njerëz u therën me thikë në veriperëndim të Anglisë të hënën.

Shërbimi emergjent tha se u ka dhënë ndihmë mjekësore tetë pacientëve të plagosur me thikë, të cilët u dërguan në tri spitale të ndryshme, përfshirë në Spitalin e Fëmijëve “Alder Hey”.

Policia në Merzysajd tha se oficerët e armatosur e kanë arrestuar një burrë dhe e kanë konfiskuar një thikë, pas raportimit të një incidenti me thikë pak para mesditës.

Nuk ka rrezik për publikun e gjerë, tha policia.

Kryeministri i Britanisë së Madhe, Keir Starmer, shkroi në rrjetin social X se ndihet i tronditur nga ky incident. “Lajm i tmerrshëm dhe

thellësisht tronditës nga Southport. Dua t'i falënderoj policinë dhe shërbimin emergjent për reagimin e shpejtë”, tha ai.

Spitali i Fëmijëve “Alder Hey” tha se ka shpallur incident të madh dhe se departamenti i emergjencës së saj është tejet i zënë.

Ai u kërkoi prindërve t'i sjellin fëmijët e tyre në emergjencë vetëm në raste urgjente.



Hovenier e prezanton zëvendësshefen e re të Misionit në Ambasadën e ShBA-së

PRISHTINË, 29 KORRIK - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier e ka prezantuar Anu Prattipatin, duke publikuar një fotografi me të.

Hovenier shkroi në rrjetet sociale se ajo do të jetë zëvendësshefe e Misionit në Ambasadën Amerikane. "Kënaqësi ta mirëpres Anu Prattipatin në Kosovë si Zëvendës Shefe e re e

Misionit në Ambasadën e ShBA-së. Mezi pres të punojmë së bashku për t'i avancuar marrëdhëniet e Kosovës dhe ShBA-së", ka shkruar ambasadori amerikan në X.



KQZ-ja prezanton disa raste të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme në Zgjedhjet për Kuvend

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 KORRIK - Fletëvotimet e pavlefshme mbeten një shqetësim i gjerë në Kosovë, pasi një numër i konsiderueshëm i tyre shpallen të tilla në çdo proces zgjedhor.

Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vetëm në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës, të cilat janë mbajtur më 14 shkurt 2021, më shumë se 27 mijë fletëvotime ishin shpallur të pavlefshme, ndërkaq gati 6 mijë të tjera ishin të zbrazëta.

Por, si duhet të plotësohet fletëvotimi, në mënyrë që të shpallet i vlefshëm dhe që pjesëmarrja e qytetarëve në votime të mos rezultojë e kotë?

Me anë të një videoje, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi ka shpjeguar se në mënyrë që një fletëvotim të shpallet i vlefshëm, votuesi duhet të votojë/zgjedhë vetëm një subjekt politik dhe deri në 10 kandidatë për deputetë të atij

subjekti politik.

Gjithashtu, ai ka prezantuar disa raste të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. 1. Çfarë ndodhë kur votuesi shënjon më shumë se një subjekt politik? Sigurisht se në këtë rast fletëvotimi do të shpallet i pavlefshëm. 2. Çfarë ndodhë kur votuesi shënjon vetëm kandidatët për deputet, por jo edhe subjektin politik? Edhe në këtë rast, fletëvotimi do të shpallet i pavlefshëm. 3. Çfarë ndodhë kur votuesi shënjon një subjekt politik dhe më shumë se 10 kandidatë për deputetë? Vota do t'i numërohet vetëm subjektit politik, por jo edhe kandidatëve. 4. Çfarë ndodhë kur votuesi shënjon një subjekt politik dhe më pak se 10 kandidatë për deputetë? Vota do t'i numërohet subjektit politik dhe atyre kandidatëve. "Pra, që vota juaj të jetë e vlefshme, votoni vetëm një subjekt politik dhe deri në 10 kandidatë për deputetë", thuhet në këtë video informuese.



104 kadetë të FSK-së janë duke studiuar në akademitë ushtarake të botës



PRISHTINË, 29 KORRIK - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se edukimi i ushtarakëve vazhdon të jetë prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes. "Njëqind e katër kadetë të FSK-së aktualisht janë duke studiuar në akademitë më të njohura ushtarake brenda dhe jashtë vendit, si në ShBA, Turqi, Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Kroaci dhe Shqipëri. Krahas shkollimit akademik, Ministria e Mbrojtjes është duke investuar në ngritjen profesionale të ushtarakëve të FSK-së përmes financimit të shkollimit dhe

trajnimeve", ka thënë Maqedonci.

Ai ka shtuar se gjashtëdhjetë e gjashtë ushtarakë janë duke ndjekur edukim profesional ushtarak dhe trajnime specialistike në programe të rëndësishme në akademi, shkolla dhe qendra trajnuese për ndërtimin e lidërshiptit ushtarak. "Një pjesëtar është duke studiuar në Kolegjin e Luftës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (US Army War College), ndërsa gjashtëdhjetë e pesë të tjerë po ndjekin kurse bazike dhe të avancuara të

zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale specialistike të mbështetjes luftarake të FSK-së. Forca jonë po ndërtohet, zhvillohet e avancohet në vazhdimësi në forcë me standarde të NATO-s, makimalisht të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta me forcat e vendeve partnere dhe aleate të NATO-s. Vazhdojmë me vendosmëri të plotë, angazhim vetëmohues dhe përkushtim maksimal drejt përbushjes së objektivit tonë", ka theksuar Maqedonci.

Gjykata Speciale në pushim veror deri më 16 gusht

PRISHTINË, 29 KORRIK - Dhomat e Specializuara kanë njoftuar se procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së, do të pauzohet për kohën e datave të përmendura për pushim veror. Sipas DHSK-së, pushimi veror fillon nga sot 29 korrik dhe përfundon më 16 gusht, ndaj gjatë kësaj periudhe nuk do të mbahen

seanca dhe disa nga shërbimet jothelbësore do jenë të minimizuara. "Siç është njoftuar në kalendarin tonë, pushimi veror në DHSK fillon të hënën, më 29 korrik, dhe përfundon më 16 gusht 2024. Gjatë kësaj periudhe nuk mbahen seanca dhe disa nga shërbimet jothelbësore do të

jenë në minimum. Megjithatë, gjykata mbetet plotësisht funksionale dhe puna vazhdon në të gjitha seksionet e DHSK-së. Gjatë pushimit mund të paraqiten parashtrime dhe përveç nëse gjykatësit kanë urdhëruar ndryshe, afatet gjyqësore vazhdojnë të jenë në fuqi", thuhet në njoftim.





Edhe 10 ditë për konvertim të patentshoferëve për serbët e Kosovës: Çfarë pastaj?

Policia e Kosovës ka bërë të ditur se nuk do t'i "tolerojë" më ato patenta që u jepen serbëve me banim në Kosovë, pas skadimit të afatit për pajisjen e tyre me patentë shoferë të Kosovës. Pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë kanë edhe dhjetë ditë afat për t'i konvertuar patentshoferët e tyre, që janë lëshuar nga autoritetet serbe në ato të autoriteteve të Kosovës

PRISHTINË, 29 KORRIK - Pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë kanë edhe dhjetë ditë afat për t'i konvertuar patentshoferët e tyre, që janë lëshuar nga autoritetet serbe në ato të autoriteteve të Kosovës. Nëse nuk veprojnë ashtu deri më 9 gusht, dhe policia i ndalon gjatë vozitjes, ata do të konsiderohen se e kanë drejtuar veturën pa patentë shoferë, kanë thënë zyrtarë të Policisë së Kosovës në disa përgjigje për Radion Evropë e Lirë (REL). Zyrtarët policorë theksojnë se, në përputhje me vendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, ndaj këtyre individëve do të shqiptohen gjoba, me mundësi të konfiskimit të automjeteve. Shuma e gjobave, sipas ligjit, është nga 500 deri në 1.500 euro. Autoritetet e Kosovës nuk i njohin dokumentet e lëshuara nga Serbia për qytetet e Kosovës. Megjithatë, në disa raste ato "tolerohen", për shkak se procesi i integritetit të serbëve në sistemin e Kosovës nuk është përfunduar

plotësisht. Nga ana tjetër, Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, të shpallur më 2008, dhe nuk është ndalur asnjëherë së lëshuari dokumente për territorin e Kosovës. Autoritetet serbe i lëshojnë këto dokumente prej qyteteve të ndryshme të Serbisë. Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, i cili ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, të dyja palët kanë arritur marrëveshje për njohjen e dokumenteve personale, por nuk është e qartë se çfarë do të ndodhë me dokumentet e lëshuara nga Serbia për serbët që banojnë në Kosovë. Prandaj, palët shpesh interpretojnë ndryshe-ndryshe marrëveshjen e Brukselit.

Çfarë do të ndodhë pas afatit?

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin verior, Veton

Elshani, ka thënë për REL-in se policia e Kosovës nuk do t'i "tolerojë" më ato patenta që u jepen serbëve me banim në Kosovë, pas skadimit të afatit për pajisjen e tyre me patentë shoferë të Kosovës.

Ai tregon se në atë rast, një individ do të gjobitet për mosposedim të patentshoferit. "Pas shqiptimit të një gjobe të tillë, vetura duhet të drejtohet nga dikush që ka patentë shofer [kosovar]. Nëse [pronari i veturës] nuk ka dikë tjetër që ta largojë makinën, ajo duhet të parkohet diku menjëherë, ose do ta konfiskojmë", thotë Elshani.

Cila është procedura për marrjen e patentshoferit të Kosovës?

Më 7 maj, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka marrë vendim për të lejuar qytetarët e komunitetit serb t'i konvertojnë patentshoferët serbë me ata të lëshuar prej autoriteteve të Kosovës. Vendimi ka hyrë në fuqi dy ditë më vonë, më 9 maj, dhe do të zbatohet deri më 9 gusht 2024. Për marrjen e patentshoferit të Kosovës, nuk duhet nënshtruar ndonjë testi të vozitjes. Krejt çfarë duhen janë: letërnjoftimi i Kosovës, patentshoferi origjinal, i lëshuar nga autoritetet serbe, dhe një certifikatë e kontrollit mjekësor.

Sa patentshoferë janë zëvendësuar?

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 27 korrik se rreth 4.000 serbë nga Kosova kanë dorëzuar kërkesë për konvertimin e patentshoferëve të tyre, të lëshuar prej Serbisë, me ata të Kosovës. Në këtë shifër bëjnë pjesë kryesisht serbë nga veriu i Kosovës, sepse ata në jug të Ibirit patentshoferët e Kosovës i kanë marrë rreth 10 vjet më parë. "I ftoj të gjithë ata që nuk kanë aplikuar ende për konvertim të patentë shoferit që ta shfrytëzojnë këtë mundësi, e cila ofrohet në të gjitha komunat deri më datë 9 gusht. Falënderoj qytetarët për bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet tona", ka thënë Kurti përmes një postimi në Facebook. Procesit të pajisjes me patentë shofer të Kosovës i ka paraprirë procesi i reregjistrimit të veturave me targa serbe në targa RKS (Republika e Kosovës), sidomos për ato me regjistrimin KM (Mitrovica e Kosovës). Procesit i reregjistrimit të automjeteve, i cili ka zgjatur prej fundit të vitit 2022 deri në mesin e dhjetor të vitit 2023, ka nxitur një sërë krizash në veri të Kosovës: daljen e serbëve nga institucionet e Kosovës, protesta, barrkada, bojkot të zgjedhjeve, dhe gjithçka kulmoi me një sulm të armatosur të një grupi të organizuar të serbëve kundër Policisë së Kosovës.

Megjithatë, sot, në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës – Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok - nuk mund të shihen targat KM, me të cilat vlerësohej se ishin të regjistruara rreth 10 mijë makina.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme të Kosovës, rreth 4.000 vetura i kanë konvertuar targat KM në RKS, ndërsa pjesa tjetër i ka regjistruar veturat e tyre në qytete të Serbisë.

Kështu, individët që kanë makina me targat BG (Beograd), KG (Kragujevc), RA (Rashkë) dhe targa të tjera të regjistruara në qytetet e Serbisë, ngasin veturat në Kosovë me autorizim, sepse vendbanimi i tyre është në Kosovë.

Me çfarë patentë shoferi mund të drejtohet një makinë me autorizim?

Veton Elshani nga Policia e Kosovës e ka parë si problematike çështjen e drejtimit të veturës me targa të Serbisë (BG, KG, RA) në Kosovë, dhe ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme po punon për gjetjen e një zgjidhjeje. Deri atëherë, sipas Elshanit, edhe pronarët e këtyre veturave do të mund të drejtojnë një automjet me patentshoferë kosovarë dhe jo serbë, që lëshohen nga autoritetet serbe për qytetet e Kosovës. "Nuk do të merren masa për ata që, për shembull, vozisin me targa BG dhe

Tahiri thotë se deputetët e LV-së kundërligjshëm zëvendësuan udhëheqësit e Komisionit hetimor për tekstet shkollore



PRISHTINË, 29 KORRIK - Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Abeler Tahiri, ka thënë se në panikun e gjetjeve të deritanishme në Komisionit Hetimor Parlamentar për hetimin e aferës së keqpërdorimit të miliona eurove në emër të subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore,

deputetët e shumicës, anëtarë të këtij komisioni kanë vendosur që ta minojnë dhe bllokojnë hetimin përfundimtar të kësaj afere, duke u mbledhur të hënën në mënyrë të paligjshme, e duke zëvendësuar kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këtij komisioni nga radhët e opozitës, e të cilët i ka zgjedhur Kuvendi. "Si

grup parlamentar iniciues të këtij Komisioni Hetimor, vendimin e sotëm të deputetëve të shumicës parlamentare e konsiderojmë jo vetëm të paligjshëm, por atak të drejtpërdrejtë mbi mandatin e deputetit si përfaqësues i popullit, vendim i cili, në të njëjtën kohë është edhe një provë shtesë se pse pushteti i frikësohet hetimit të

kësaj afere dhe pse ka vendosur që në mes të procesit t'a bllokojnë këtë komision. Në bazë të nenit 10 të ligjit në fuqi për Hetimin Parlamentar, kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit Hetimor i takon opozitës, prandaj edhe Kuvendi në seancë plenare ka vendosur për përbërjen e tij me rastin e themelimit të

Komisionit", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se për këtë vendim të paligjshëm e të turpshëm, do të kërkojmë sqarime edhe nga Kryetari i Kuvendit, para se t'i drejtohem Prokurorisë Speciale për të hetuar këtë aferë korruptive, që ka për kryeprogoniste ministren e Arsimit Arbërie Nagavci.

Kurti ua rikujton sërish mërgimtarëve se është hapur Dritarja për Investime të Diasporës

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije sërish se për bashkatdhetarët tanë që po vijnë për pushime në Kosovë e që duan të kthehen në vendlindje, përveç dyerve që i kanë të hapura, nga muaji korrik është hapur edhe Dritarja për Investime të Diasporës.

Ai ka thënë se përmes saj qeveria do të garantojë huatë e bizneseve me pronarë nga mërgata që duan të investojnë në Kosovë. "Ajo është zgjidhja ndaj vështirësive që mërgata jonë ndërmarrëse ka pasur deri

më tani në qasjen në financim në bankat e vendeve ku ata jetojnë, por edhe në bankat tona në mungesë të historikut kreditor.

Dritarja për Investime të Diasporës u mundëson atyre që të aplikojnë për kredi deri në tre milionë euro nëpër bankat e Kosovës dhe pjesëmarrja e tyre me kapital duhet të jetë së paku 20%. Pas aplikimit dhe nëse përmbushen të gjitha kriteret, Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë do të ofrojë garanci për kreditë deri në dy milionë euro", ka thënë Kurti.



tregojnë patentë shoferë të Kosovës", thekson ai.

Ai shton se, në bazë të ligjit, një gjë e tillë në fakt nuk është e mundur, por që autoritetet e Kosovës po

përpiqen të gjejnë një zgjidhje të këtij problemi.

Në Serbi, autorizimet e tilla lëshohen në bazë të të dhënave të letërnjoftimit dhe patentë shoferit.

Kjo do të thotë se, serbët nga Kosova, të cilët nuk e kanë ndërruar vendbanimin në sistemin serb, dhe drejtojnë veturë me targa të një qyteti të Serbisë, në autorizim kanë

të dhëna të letërnjoftimit që lëshon Serbia për qytetet e Kosovës.

Këtë letërnjoftim se pranojnë autoritetet e Kosovës.

Në këtë rast, autoritetet e Kosovës,

tash për tash, e pranojnë autorizimin serb, por jo letërnjoftimin dhe as patentshoferin e lëshuar prej autoriteteve serbe.

Policia në rajonin e Mitrovicës së jugut realizon kontrolle të jashtëzakonshme

MITROVICË E JUGUT, 29 KORRIK - Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë në vazhdimësi po ndërmer masa dhe veprime parandaluese.


Në saj të kësaj, në përputhje me autorizimet hetuesit e Sektorit Rajonal të Hetimeve në mbështetje edhe të njëjve tjera, në tri ditët e fundit në orët e mbrëmjes kanë realizuar kontrolle në disa

lokale në qytetet Mitrovicë e Jugut, Vushtrri e Skenderaj. Kontrollat e jashtëzakonshme janë realizuara në lokacione të ndryshme, ku janë kontrolluar mbi 600 persona, ku përveç një rasti në një lokal (kafiteri) në Mitrovicë, ku të një person është gjetur dhe sekuestruar një armë e llojit pistoletë, tek personat tjerë nuk është gjetur asgjë e kundërligjshme.

Gjatë realizimit të këtyre

kontrolleve, policia është përkujdesur që të gjitha masat e ndërmarra të jenë në përputhje me ligj dhe akte tjera normative duke respektuar të drejtat dhe liritë e çdo qytetari.

Policia, falënderon qytetarët për mirëkuptim gjatë kontrolleve të kësaj natyre, që kanë për qëllim parandalimin e gjërave të kundërligjshme që hasen në posedim të qytetarët.



Dardan Krivaqa dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjen e Marigona Osmanit

PRISHTINË, 29 KORRIK - Gjykata Themelore në Ferizaj ka shpallur sërish fajtorë Dardan Krivaqën dhe Arbër Sejdiun, të akuzuar për vrasjen e Marigona Osmanit.

Krivaqa është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e Osmanit, ndërsa Arbër Sejdiu është dënuar me 15 vjet burgim për ndihmë në kryerjen e veprës "vrasje e rëndë", sikurse në aktgjykimin e parë, të shqiptuar në gusht të vitit të kaluar.

Marigona Osmani ka qenë 18-vjeçare kur është vrarë, më 22 gusht të vitit 2021, në banesën e të akuzuarit kryesor, Dardan Krivaqa, në qytetin e Ferizajt.

Më 23 shkurt, Apeli i ka miratuar ankesat e avokatëve mbrojtës për aktgjykimin dhe e ka kthyer rastin në rigjykim, me arsyetimin se ka pasur shkelje procedurale gjatë procesit.

Sipas aktakuzës, Krivaqa, më 21

gusht 2021, rreth orës 10:14, në banesën e tij, pa pëlqimin e tani të ndjerës Marigona Osmanit, e ka detyruar atë të kryente marrëdhënie seksuale dhe e kishte abuzuar e maltretuar në forma të ndryshme.

Sipas aktakuzës, një ditë më pas, më 22 gusht 2021, Krivaqa dhe Sejdiu e kanë vrarë të ndjerën në përpjekje për të fshehur veprën penale të dhunimit.

Krivaqa e Sejdiu, e kanë dërguar trupin e pajetë të viktimës në spitalin e qytetit, dhe më pas janë larguar në drejtim të panjohur.

Ata janë akuzuar edhe për kryeje të dhunimit, por janë shpallur të pafajshëm në këtë pikë, në mungesë provash.

Nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024, në Kosovë janë vrarë 57 gra. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.



Rekomandohet ngritja e nivelit të cilësisë së të dhënave në Prokurorinë e Apelit



PRISHTINË, 29 KORRIK - Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, mbajti të hënën takim të radhës sipas agjendës së paraparë.

Në këtë takim morën pjesë anëtarët e Komisionit dhe të grupit punues për përgatitjen e Udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, Mats Persson, koordinator i Komisioneve të Përhershme të KPK-së, zyrtarët e Njësitit për

Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë dhe të Departamentit të Teknologjisë Informative të Sekretariatit të KPK-së.

Fillimisht, udhëheqësi i grupit punues për përgatitjen e Udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Admir Shala, prezantoi draftin e raportit për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, përfshirë konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

Anëtarët e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, vlerësuan se draftraporti mund të ndihmojë në standardizimin dhe përmirësimin e procedurave për trajtimin e këtyre rasteve, si dhe rekomanduan ngritjen e nivelit të cilësisë së të dhënave në Prokurorinë e Apelit, si dhe diskutuan edhe për vizitat që do t'i realizojnë në të gjitha prokuroritë e vendit, ku do të mbikëqyrin zhvillimin e procesit të punës përmes SMIL-it dhe do të identifikojë nevojat e infrastrukturës fizike.

Ministri Vitia vizitoi komunat Zubin Potok dhe Leposaviq

PRISHTINË, 20 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi dhe ministrin për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashi, vizituan Komunën e Leposaviqit dhe Komunën e Zubin Potokut. Ata u pritën nga kryetari i Komunës së Leposaviqit, Lulzim Hetemi

dhe kryetari i Komunës së Zubin Potokut, Izmir Zeqiri. Me këtë rast, u bë pranim-dorëzimi i dy veturave për shërbime shëndetësore.

Këto vetura janë të destinuara kryesisht për fshatrat e këtyre komunave, duke mundësuar që ekipet shëndetësore të kenë qasje në të gjithë territorin e komunës për programin e

vizitave mjekësore në shtëpi.

Gjatë kësaj vizite, u diskutuan gjithashtu mundësitë për investime të tjera në këto komuna, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore dhe për të qenë më afër qytetarëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.



Nënshkruhet marrëveshja për financimin e magjistrales "Prishtinë - Mitrovicë" me vlerë 13 milionë euro

PRISHTINË, 29 KORRIK - Të hënën është mbajtur ceremonia e nënshkrimit për financimin e rrugës "Prishtinë - Mitrovicë". Prezentë ishin ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, drejtori ekzekutiv i Fondit Saudit për Zhvillim, Sultan A. Almarshad si dhe ambasadori jo-rezident i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Kosovë, Faisal Ghazi Hifzi. Në fjalën e tij hapëse, ministri Murati tha se me nënshkrimin e marrëveshjes në fjalë përmbillet edhe pjesa e mbetur e financimit të projektit për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugës "Prishtinë - Mitrovicë". Ministri Murati theksoi përkushtimin e Qeverisë për të thelluar marrëdhëniet me

Mbretërinë e Arabisë Saudite drejt investimeve në sektorin e infrastrukturës dhe sektorë të tjerë me rëndësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga ana e tij, ministri Aliu tregoi se ky projekt synon modernizimin e rrugës dhe vjen në linjë me punët dhe prioritetet e Qeverisë të cilat çdo herë synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Aliu gjithashtu theksoi se ky projekt është i pari projekt infrastrukturor në Kosovë që mbështetet nga Fondi Saudit për Zhvillim dhe se synohet që pas këtij projekti, partneriteti të thellohet edhe më tej.

Ndërsa, drejtori Almarshad përmendi bashkëpunimin e vazhdueshëm me Qeverinë e Kosovës duke theksuar se projekti për financimin e magjistrales "Prishtinë -



Mitrovicë" parasheh zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës nacionale duke e zvogëluar

kështu edhe trafikun. Almarshad falënderoi Qeverinë për mirëpritjen duke

përmendur edhe njëherë rolin e projektit për zhvillimin ekonomik të vendit.

Mosekzekutimi i pagave për minatorët e Trepçës, flasin nga menaxhmenti i ndërmarrjes

PRISHTINË, 29 KORRIK- Punëtorët e minierës së Stan Tërgut ende nuk e kanë marrë pagën e muajit qershor për shkak të problemeve financiare me të cilat po përballet ndërmarrja. Kështu tha në një përgjigje me shkrim për Telegrafin, zyrtarja për komunikim me publikun, njëherësh asistente e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes "Trepça", Donika Osmani-Mehmeti.

Sipas saj, kjo vjen si rezultat i borxheve të akumuluar ndër vite dhe problemeve financiare të trashëguara nga e kaluara. "Bordi Mbikëqyrës i ndërmarrjes Trepça Sh.A së bashku me menaxhmentin janë në kontakt të vazhdueshëm me qeverinë për ta zgjidhur çështjen në fjalë. Jemi duke e trajtuar me seriozitet dhe shpresojmë në zgjidhje të shpejtë", ka thënë ajo.

Edhe drejtori i Minierës Trepça,



Shyqyri Sadiku, në një prononcim për Telegrafin ka thënë se mos ekzekutimi i pagave të punëtorëve të Trepçës tashmë është kthyer në rutinë,

dhe kjo siç u shpreh "minierës po i shkakton humbje të mëdha".

Sadiku tha se interesi i tyre është që kjo situatë të

stabilizohet dhe punëtorët e minierës t'i kthehen punës. "Kjo po na shkakton humbje të mëdha. Interesi ynë është që të dalim nga kjo situatë e të stabilizohemi me paga. Punëtorët po thirren në një marrëveshje që kanë bërë në minierë. Punëtorët kanë bërë një marrëveshje me ish-deputetët që ekzekutimi i pagave do të bëhet deri më datë 10. E si po vjen data 10 punëtorët s'po punojnë se s'ka paga. E kjo është bërë si standard. Dhe neve po dëmton", tha ai duke shtuar se "Çdo orë humbje në punë është kosto për ne".

I pyetur se pse nuk po bëhet ekzekutimi në kohë i pagave për punëtorët e Minierës Trepça, ai tha: "Trepça gjendjen financiare nuk e ka të mirë. Kam thënë dhe më herët, në muajin mars s'kemi mujt me punu hiç se s'kemi pas furnizim me

eksploziv. D.m.th krejt muajin s'kemi pas prodhim fare. E kjo nuk është për fajin e punëtorëve. E, muaji mars na ka godit edhe për të ardhmen se s'është punuar hiç".

Ndryshe, në lidhje me këtë sot kanë reaguar edhe nga Sindikata e Punëtorëve të Trepçës.

Në reagimin e tyre thuhet se qeveria nuk ka aspak interesim për fatin e minierës dhe minatorëve.

Më tej, Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës thotë se "një qasje e tillë refuzuese ndaj ndërmarrjes Trepça Sh.A dhe minatorëve, duke i lënë të njëjtët buzë humnerës dhe duke ia pamundësuar ekzekutimin e pagave gati për dy muaj nën këto kushte të rënda financiare të minatorëve përben shqetësim serioz dhe sfidë që kërkon zgjidhje të menjëhershme".

Asetet e fondeve pensionale kanë arritur vlerën 2.94 miliardë euro

PRISHTINË, 29 KORRIK - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës sipas kalendarit të publikimeve ka publikuar statistikën për institucionet tjera financiare për muajin qershor 2024.

Asetet e fondeve pensionale në fund të muajit qershor 2024 kanë arritur vlerën e 2.94 miliardë euro. Struktura e aseteve të sektorit pensional dominohet nga letrat me vlerë të kapitalit, që përbëjnë 78.02 % të gjithë aseteve.

Asetet e ndërmjetësve tjerë financiar në fund të muajit qershor 2024 kanë shënuar

vlerën e 583.66 milionë euro, duke qëndruar pothuajse në nivel të njëjtë me atë të muajit paraprak.

Struktura e aseteve të këtyre institucioneve dominohet nga kreditë, të cilat përbëjnë 67.93% të gjithë aseteve. Kreditë bruto të ndërmjetësve tjerë financiar në qershor 2024 arritën vlerën e 396.48 milionë euro, e cila përfaqëson rritje për 6.13 milionë euro krahasuar me periudhën paraprake. Sipas sektorëve, kreditë ndaj ekonomive familjare dominojnë me 59.76% në totalin e kredive të

ndërmjetësve tjerë financiar. Vlera e kredive të reja të emetuara nga ndërmjetësit tjerë financiar në muajin qershor 2024 ishte 51.60 milionë euro.

Asetet e kompanive të sigurimit në fund të muajit qershor 2024 arritën vlerën e 326.21 milionë eurove, e cila përfaqëson rritje për 7.59 milionë euro krahasuar me muajin paraprak. Struktura e aseteve në sektorin e sigurimeve përbëhet nga bilanci me bankat komerciale, që përbëjnë 44.97%, letrat me vlerë dhe asetat e tjera 28.39% dhe risigurimet me pjesëmarrje 15.48%.



Këshilltarë, strategë dhe financues të mëdhenj: Ekipi Kamala



Të gjithë burrat (dhe gratë) e zëvendëspresidentes. Një "Ekip Kamala" i përbërë nga anëtarë të familjes, këshilltarë, donatorë dhe aleatë, një pjesë kalifornianë si ajo – pra të përkushtuar, në modë, holistik dhe bohémë – të cilët në vetëm një javë jo vetëm që kanë zëvendësuar veteranët e politikës që përbënin rrethin magjik dhe pak si tepër protektiv të Presidentit Biden, por edhe kanë qenë në gjendje të mobilizonin kaq shumë mbështetës, të vegjël e të mëdhenj sa të mblidhnin deri në 200 milionë dollarë: ndihmë vendimtare për t'i dhënë një shtysë të madhe fushatës.

Familja

Kolona e Harris është burri i saj Doug Emhoff, një avokat hebre, i cili hoqi dorë nga karriera për të marrë rolin e Zotërisë së Dytë, duke zgjedhur luftën kundër antisemitizmit si kauzën e mandatit të tij. Tani ai aspiron të jetë bashkëshorti i parë i një presidenteje. Një e besuar është motra e saj më

e vogël Maya, konsulente e fushatës së Hillary Clinton në vitin 2016 dhe më pas drejtoare, në vitin 2020, e fushatës së dështuar të Kamalës, e cila synonte nominimin mes demokratëve. Më pas vjen kunati i saj Tony West, bashkëshorti i Maya-s, ish-kryeprokuror i Departamentit të Drejtësisë dhe tani një peshë e rëndë në Uber, një grumbullues i aftë fondesh. Dhe vajza e të dyve, mbesa Meena, një producente e njohur, e cila është nominuar disa herë për Çmimet "Tony", që janë "Oscar"-ët e Teatrit: herën e fundit për "Suffs", muzikali mbi refugjatët, që ajo prodhoi me Hillary-në dhe Malala-n.

Këshilltarët dhe strategët

Harris ka konfirmuar disa figura që tashmë po punonin me të, duke filluar nga Phil Gordon, diplomat ekspert për Evropën dhe Lindjen e Mesme, dikur këshilltar i saj për sigurinë kombëtare. Së bashku me Mike Pyle, ish-i dërguar i Biden në G20 dhe ish-këshilltari i tij ekonomik. Më pas është Rohini

Kosoglu, këshilltare për politikën e brendshme që e ka ndihmuar në të kaluarën të përgatitet për t'u përballur me debatet. Përpjekja e vazhdueshme për të tërhequr ish-besnikët e Obamës si Karen Dun, David Plouffe dhe Rahm Emanuel, ish-kryetar i bashkisë së Çikagos dhe më pas shefi i shtabit të Obamës, flet qartë për synimin për të inicuar më shumë politika probuxhetore se sa ato aktuale. Për të vlerësuar zëvendësit e mundshëm ajo telefonoi ish-sekretarin e Drejtësisë të Barackut, Eric Holder. Në krye të fushatës ka mbajtur Jen O'Malley Dillon, ish-këshilltarja kryesore e Biden-it. Dhe Julie Chávez Rodríguez, mbesa e kryesindikalistit legjendar, Cesar. U ka afruar si bashkëpresident edhe guvernatoren e Miçiganit, Gretchen Whitmer, të cilën disa shpresonin ta shihnin si zëvendësen e saj.

Financuesit

Harris ka shumë miq në Wall Street. Kryesori është Jon Henes,

një konsulent i specializuar në falimentimet e korporatave, i cili tashmë ka koordinuar mbledhje të rëndësishme fondesh për të. Ajo është gjithashtu shumë e afërt me Ray McGuire, president i Lazard, një kompani globale e konsulencës financiare, i njëjti që kandidoi edhe në zgjedhjet primare për postin e kryetarit të bashkisë së Nju Jorkut. Gruaja e tij, Crystal McCrary, është një peshë e rëndë në Projektin Seneca, e angazhuar për mobilizimin e grave në shtetet e lëkundur. Aleatë janë miliarderi Jonathan Grey, president i kompanisë së investimeve Blackstone, Roger Altman, bashkëthemelues i Evercore dhe Marc Lasry, bashkëpronar i ekipit të basketbollit Milwaukee Bucks.

Sipërmarrësit

Reed Hastings, presidenti i Netflix, bëri presion të fuqishëm për tërheqjen e Biden-it: dhe menjëherë më pas nxitoi të derdhte 7 milionë dollarë në

fushatën e Harris. E njëjta gjë u shpreh edhe nga Reid Hoffman, bashkëthemelues i LinkedIn, i cili tha publikisht "Ajo do të jetë e mirë për biznesin" (duke zemëruar si demokratët ashtu edhe republikanët). Në Silicon Valley mbështetet tek Brad Smith i Microsoft-it dhe mbi të gjitha te Sheryl Sandberg, ish-drejtoreshë e operacioneve të Meta-s.

Hollywood

Me bashkëshortin Doug të specializuar në të drejtat e autorit për filma, çifti ka shumë miq në Hollywood. Chrisette, gruaja e Reginald Hudlin, producentit afrikano-amerikan të "Django Unchained", organizoi takimin ku të dy u njohën. Miqtë e ngushtë janë Dana Walden, bashkëpresidente e Disney Entertainment, Nicole Avant, gruaja e bashkëdrejtorit të Netflix, Ted Sarandos. Dhe Laura Shell, gruaja e Jeff, CEO i Paramount.

La Repubblica – Bota.al

A do të nxjerrë jashtë loje paratë Inteligjenca Artificiale?



Nga Jean-Pierre LANDAU,
Project Syndicate

Sot i kemi harruar virtutet e vërteta të parasë. Zakonisht e shohim atë në terma thjesht instrumentalë. Pra si një mjet që e lehtëson shkëmbimin dhe e ruan vlerën me kalim kohës. Krahasuar me shkëmbimet fizike të mallrave, monedhat metalike dhe kartëmonedhat janë shumë të përshtatshme.

Megjithatë, paraja është më shumë se një instrument. Siç shkroi dikur shkrimtari i famshëm rus Fjodor Dostoevsky “paraja është liria e krijuar”. Ajo e mbështet ekzistencën tonë si individë autonome në një ekonomi të decentralizuar.

Por situata do të jetë shumë ndryshe, nëse një ditë do të jetojmë në një botë të qeverisur nga një Inteligjencë Artificiale (AI), e pajisur me informacion të plotë dhe me aftësi përpunuese të pafundme. Në këto kushte, paraja mund të mos ketë më asnjë rol për të luajtur.

Për të kuptuar se si na mban të lirë paraja, kujtoni pak çdo zinxhir transaksionesh. Kur marrim para, ne jemi nën kontroll të situatave. Kështu, varet nga ne që të vendosim nëse do ta grumbullojmë apo do ta shpenzojmë për çfarëdo gjëje që zgjedhim. Vetëm paratë na e

japin këtë aftësi.

Për më tepër, paratë janë universale. Dhe ky tipar i tyre ju lejon të blini çdo gjë, në çdo kohë, nga kushdo, dhe ai shitës mund të gendet gjithnjë e më shumë kudo nëpër botë. Kjo liri specifike nuk vjen nga pasuria, por nga mundësia e zgjedhjes.

Por kjo larmi zgjedhesh nuk duhet të merret si diçka e mirëqenë, sepse instrumentet e pagesave kanë qenë gjithmonë të ndjeshme ndaj ndërhyrjeve paternaliste. Në shekullin XIX, disa kompani do t'i paguanin punonjësit e tyre me çeqe që pranoheshin vetëm në dyqanet në pronësi të saj.

Sot teknologjia bën të mundur lëshimin e “parave të programueshme” me një qëllim të veçantë, përdorim të kufizuar, dhe madje edhe një datë të paracaktuar. Shenja të tilla dixhitale mund të përdoren për të ndaluar konsumin e “jo të vërtetshëm” (si alkooli ose duhani) nga përfituesit e ndihmës shtetërore.

Ne kemi nevojë për para, pasi jetojmë në një ekonomi tregu, dhe jo në një botë të para-programuar. Mbajtja e parave na mbron nga pasiguria. Kërkesa për para rritet ndjeshëm gjatë krizave, pasi njerëzit duhet të përgatiten për të gjithë skenarët.

Por tani imagjinoni një të ardhme ku makinat organizojnë, vendosin dhe kryejnë të gjitha aktivitetet

ekonomike. Ato kryejnë transaksione ndërmjet tyre, kreditojnë dhe debitojnë llogaritë reciproke, dhe sigurojnë automatikisht disiplinën dhe zbatimin e kontratave.

Nuk ka asnjë refuzim dhe asnjë falimentim. A do të kemi ende nevojë për paratë?

Në fakt, një botë të tillë po e shohim tashmë, edhe pse pjesërisht. Një dekadë më parë, Hal Varian, kryeekonomist në kompaninë Google, vuri në dukje se në të gjithë ekonominë tonë të dixhitalizuar “ekziston një kompjuter në mesin e çdo transaksioni”. Shumë nga veprimet tona të përditshme janë të automatizuara.

Tregtia algoritmike në shumë tregje të letrave me vlerë, por edhe pagesat po programohen gjithnjë e më shumë paraprakisht. Nëse materializohet vizioni i mbrojtësve të kriptomonedhës mbi të ardhmen, atëherë “kontratat inteligjente” do të drejtojnë ndërmjetësimin financiar në një univers financash të decentralizuar.

Madje disa njerëz sugjerojnë se nën drejtimin e politikës monetare, algoritmet e sofistikuar mund të zëvendësojnë deri edhe bankierët e Bankave Qendrore të çdo vendi. Gjithsesi për momentin, ne po përdorim makineritë. Njerëzit po marrin ende vendime si agentë të lirë, duke shprehur preferencat

dhe duke vepruar sipas tyre.

Bankat Qendrore nuk ndjekin verbërisht rregullat. Ato bëjnë gjykimet e tyre, pasi marrin parasysh kompromiset e vështira, veçanërisht në kohë krize, ose kur përballen me goditje negative në anën e ofertës. Në fakt, në një ekonomi të automatizuar dhe nën kontrollin njerëzor, paratë janë më të nevojshme se kurrë më parë. Por tani që dixhitalizimi e ka zhdukur distancat dhe kohën, edhe ato duhet t'i përshtaten rrethanave të reja. Pra edhe paratë duhet të jenë dixhitale, duke u shkëmbyer përmes një veprimi të thjeshtë dhe direkt në telefonat tanë celularë.

Pra një para elektronike, e cila që mund të transferohet menjëherë në të gjithë botën, pa pasur nevojë të kalojë tranzit përmes një rrjeti kompleks llogarish dhe palësh të ndërmjetme. Ky prag do të kalojë nëpërmjet Inteligjencës Artificiale. Disa skenarë, projektojnë një botë ku AI nuk përpunon thjesht informacionin dhe zbaton disa komanda, por merr edhe vendime. Madje përcakton objektivat e saj. Këto sisteme do të ishin kësisoj “agentët”, duke vepruar sipas preferencave që mund të mos përputhen domosdoshmërisht me ato të njerëzve.

Me këto aftësi, Inteligjenca Artificiale mund të marrë përsipër shpërndarjen e burimeve dhe të ardhurave. Një sistem i tillë, do të

vlerësonte miliona ekuilibrat e mundshëm ekonomikë, dhe do të identifikonte atë që e konsideron si më të preferueshëm. Ky vizion i “tekno-socializmit”, është shumë larg modelit të një shoqërie të decentralizuar dhe të lirë.

Ai do të ishte një version i teknologjisë së lartë i planifikimit qendror komunist të modës së vjetër. Debatet mbi të ardhmen e Inteligjencës Artificiale i referohen shpesh “veçantisë”, pra momentit kur AI-të do të kenë aftësinë për ta përmirësuar dhe rritur veten, duke i tejkaluar kësisoj me shpejtësi njerëzit në të gjitha përmasat e inteligjencës.

Në këtë skenar, njerëzit nuk do të mund të kontrollonin dot më fatin e tyre. Por a do të ndodhë ndonjëherë diçka e tillë? Sot për sot ka debate dhe mosmarrëveshje të mëdha midis ekspertëve të fushës, por paratë mund të shërbejnë si një tregues ideal mbi atë që na pret. Shenja më e mirë që do të tregonte se Inteligjenca Artificiale do të na e kalonte ne krijuesve të saj, do të ishte nëse paratë bëhen të parëndësishme në jetën ekonomike. Një botë pa para, mund të jetë teknikisht e realizueshme. Por nëse ia vlen apo jo të jetojmë në një botë të tillë, kjo është një çështje tjetër.

Shënim: Jean-Pierre Landau, profesor i asociuar i ekonomisë në Universitetin Sciences Po, Paris.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Sot shorti për Botëror, Kosova në vazon e parë

Prishtinë, 29 korrik - Të martën prej orës 11:00 në Vjenë do të tërhiqet shorti për fazën e parë kualifikuese për Kampionatin Botëror 2025 për hendbolliste. Në fazën e parë kualifikuese paraqiten 12 ekipe kombëtare. Ndarja e tyre në vazo është bërë në bazë të ranglistës aktuale. Dhe

Kosova është në vazon e parë, falë sukseseve gjithnjë e më të mëdha në vitet e fundit. Italia, Greqia, Kosova dhe Finlanda janë në vazon e parë. Izraeli, Luksemburgu, Lituania dhe Bosnjë-Hercegovina janë në vazon e dytë, ndërsa Bullgaria, Britania e Madhe, Belgjika dhe Estonia në vazon e tretë.

Faza e parë kualifikuese do të zhvillohet në formë turneu. Do të formohen katër grupe me nga tri kombëtare. Fituesi i grupit kualifikohet në fazën e dytë, përkatësisht në plejof. Ndeshjet kualifikuese do të zhvillohen prej 25 deri më 27 tetor të këtij viti. Botërori i vitit të ardhshëm mbahet në Gjermani dhe Holandë.



Akili dhe Nora eliminohen nga Lojërat Olimpikë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Xhudisti Akil Gjakova ka pasur paraqitje të mirë në Lojërat Olimpikë "Paris 2024", por ka mbetur pa medalje olimpikë, pasi është mposhtur edhe në repesazh. Akili pësoi humbje nga xhudisti japonez, Soichi Hashimoto. Gjakova kaloi në repesazh, pasi u mposhtë në gjysmëfinale nga numri një i botës në kategorinë e tij, xhudisti nga Azerbajxhani, Heydarov. Duhet cekur se xhudisti i Kosovës fillimisht e mposhti Daniel Cargnin nga Brazili, pastaj e mposhti edhe Samuel Gassner nga Austria, derisa në çerekfinale e mposhti italianin, Manuel Lombardo. Të hënën nga Lojërat Olimpikë është eliminuar edhe Nora Gjakova. Kjo e fundit nuk arriti ta kaloj kundërshtaren e saj mongolezen Enkhrillen

Lkhagvatogoo. Fituesja e medaljes së artë në olimpiadën e kaluar, e humbi luftën pas tri shidove, dënimeve të marra nga referi për shkak të mungesës së luftës, ose pasivitetit të treguar. Pas eliminimit të Akilit nga "Paris 2024", trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka thënë se xhudisti në fjalë ka luftuar si një luan, por se me të nuk ishte fati. "Tri fitore të mëdha, Azeri e Japonezi ndalën medaljen e parë për shtetin e Kosovës për meshkuj pas luftës! Pesë lufta të çmendura dhe të forta. Ishe në çdo element më i mirë në gjysmëfinale por në sport ndonjëherë fati luan rolin e vet!", ka thënë Kuka, i cili e ka komentuar edhe humbjen e xhudistes Nora Gjakova, për të cilën ka thënë se ka garuar e lënduar. "Nora sot garoi e lënduar por e pati dëshirën edhe një herë të garoj në Lojëra Olimpikë, jo për veten por për

shtetin tonë, për popullin shqiptar, por nuk eci ashtu si menduam por je kampione olimpikë dhe e tillë do mbetesh për mua krejt jetën! Shkojmë më tutje ...", ka shtuar Kuka. Duhet theksuar se medalje për Kosovën në Olimpiadë siguroi Distria Krasniqi, e cila e fitoi medaljen e argjendtë.

Nga Lojërat Olimpikë eliminohet edhe Donjeta Sadiku

Të hënën në mbrëmje nga Lojërat Olimpikë është eliminuar edhe Donjeta Sadiku që është mposhtur nga kolumbiania Pana Valde me pikë. Boksierja e Kosovës e filloi me kujdes të shtuar në raundin e parë, por që ishte një angazhim jo edhe i lartë në tempo. Edhe raundi i dytë ishte skenar i të parit, me



Donjetën që kërkonte të dilte përpara, por që kolumbiania ishte e vështirë për t'u përballuar. Në raundin e tretë ishte një ofensivë e plotë nga Sadiku, por që kjo nuk i mjaftoi. Boksierja

Sadiku nuk ia doli të kalonte tutje, duke mbetur pa medalje në këto Lojëra Olimpikë. Ajo u mposht 3-2 në pikë, ndërsa do të shpresojë që të ketë paraqitje më të mira pas katër viteve të ardhshme.

Vazhdon pjesa e dytë e kursit për Licencën A të UEFA-s, ligjëron Dany Ryser

PRISHTINË, 29 KORRIK, 2024 - Po vazhdon pjesa e dytë e kursit për Licencën A të UEFA-s për trajnerë në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Nga afër fazën e dytë të këtij kursi po e ndjek edhe Dany Ryser, që gjithashtu është edhe ligjërues i këtij kursi: "Është pjesëmarrja ime e parë në këtë kurs dhe, për të qenë i sigurtë, jam këtu edhe për të parë si funksionojnë gjërat. Jam këtu gjithashtu për të mësuar rreth performancës së kandidatëve dhe ky është një proces që po e njohim. Është shumë herët për

të dhënë vlerësime përfundimtare. Kemi filluar më shumë se një vit më parë në përgatitjen e kësaj licence dhe kursi do të përfundojë deri në fund të vitit apo më së largu në fillim të vitit të ardhshëm. Ky është një kurs-pilot që e organizojmë në përputhje me konventën e UEFA-s. Bazuar në këtë kurs, ne do të shkruajmë një raport përfundimtar dhe do të japim rekomandimet për këtë edukim në FFK", k thwnw Ryser. Përveç tij, ligjërues në këtë kurs është edhe instruktori i njohur Klaus Stark, teksa



kandidatët që janë pjesë e kursit janë të kënaqur me ecurinë e deritashme. "Normalisht që është kënaqësi të jesh pjesë e gjeneratës së parë të Licencës A në Kosovë. Kemi mësuar shumë gjëra. Po shohim se metodologjia e futbollit evropian veçse është zhvilluar dhe ka kaluar në një nivel tjetër. Kemi kënaqësinë që këtu sot e kemi edhe një ndër instruktorët më të falshëm të UEFA-s, Dany Riser, prej të cilit presim të marrim shumë informacione të reja, që futbollin tonë ta ngrisim në një

nivel tjetër", tha Granit Dervisholli, pjesë e këtij kursi. Krahas ndjekjes së ligjëratave, trajnerët e përfshirë në këtë kurs do të kenë edhe punën praktike dhe monitorimin në klube. Në përfundim të kursit, ata do t'i nënshtrohen një provimi dhe kandidatë që kalojnë me sukses do të pajisen me Licencën A të UEFA-s. Ky kurs është një hap i madh përpara për futbollin kosovar dhe një dëshmi e përkushtimit të FFK-së për të ngritur nivelin profesional të trajnerëve në vend.

Sainz largohet nga Ferrari

MADRID, 29 KORRIK - Spanjoli Carlos Sainz Jr. (29) largohet nga Ferrari në fund të këtij sezoni dhe do të vozisë për Williams për dy vjetët e ardhshme, njoftoi ekipi britanik i Formula 1. Ferrari njoftoi në shkurt se kishte

punësuar shtatë herë kampionin e botës, britanikun Lewis Hamilton, andaj ishte e qartë se Sainz do të kërkonte një ekip tjetër. "Jam i lumtur që do të vozis për Williams nga viti 2025. Nuk është sekret që këtë vit tregu

i shoferëve ishte i ndërlikuar për arsye të ndryshme dhe mu desh pak kohë për të marrë një vendim", ka thënë 29-vjeçari spanjoll, i cili ka vozitur për Ferrarin që nga 2021. U spekulua se Sainz mund të zëvendësojë

Hamiltonin te Mercedes, por edhe të vazhdojë karrierën te Sauber apo Alpine. Sainz arriti tri fitore gjatë karrierës dhe ishte ndër tre më të shpejtët 23 herë. Ai gjithashtu voziti për Toro Rosso, Renault dhe McLaren.





UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref.nr. 01 / 1559 Dt. 29 / 07 2024

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan si dhe nenit 11 të Rregullorës për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/1328 datë 26.06.2024, në mbledhjen XV të mbajtur më datë 25.07.2024, Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, vendosi të shpall:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për këto Fakultete:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Edukimi gjithëpërfshirës, Vështirësitë në të nxëniet (programi Arsimi Parashkollor); Arsimi gjithëpërfshirës (master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor; Praktika pedagogjike IV (programi Arsimi Fillor); Edukimi në fëmijërinë e hershme (Programi Parashkollor (Z); Vlerësimi në arsim (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).

II. FAKULTETI JURIDIK

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

(O) E drejta e procedurës penale – Pjesa e posaçme; (O) E drejta e krahësuar; (O) Praktika Profesionale; (Z) Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale; (Z) Etika ligjore dhe profesionale dhe (Z) Psikologjia gjyqësorë.

III. FAKULTETI EKONOMIK

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Aftësi të shkrimit në biznes (MMSH) Aftësi të shkrimit në biznes (FKA), Përgjegjësia Sociale e Korporatave, Komunikimi në biznes, Sistemi i Menaxhimit të Bazës së të Dhënave me plotësim të normës në FShK për Shkrim Akademik.

IV. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

I. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha e Shkencave Kompjuterike në nivelin Master: E-Qeverisja:

Semestri Dimëror

1. Informatika Sociale (Z) - Semestri I, 2 orë
2. Arkivimi digjital dhe sistemet e informimit (O) - Semestri III, 2 orë
3. Programet aplikative në E-Qeverisje (O) - Semestri III, 2 orë

Semestri Veror

1. Programimi dhe E-Qeverisja (O) - Semestri II, 2 orë
2. Databaza për E-Qeverisja (O) - Semestri II, 2 orë
3. Zhvillimet në Cloud (Z) - Semestri II, 2 orë

II. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha e Shkencave Kompjuterike në nivelin Master: Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificiale (SKIA):

Semestri Dimëror

1. Sistemet Matëse dhe Metrika (O) - Semestri III, 2 orë
2. Sistemet e bazuara në sensorë (O) - Semestri III, 2 orë
3. Mekatronikë (Z) - Semestri I, 2 orë

Semestri Veror

1. Sensorët dhe Elektronika (O) - Semestri II, 3 orë
2. Automatizimi Industrial dhe Inteligenca Artificiale (O) - Semestri IV, 3 orë

III. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha e Shkencave Kompjuterike në nivelin Master: Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificiale (SKIA):

Semestri Dimëror

1. Teoria e Kontrollës dhe Praktika (O) - Semestri I, 2 orë
2. Përpunimi Digjital i Sinjaleve (O) - Semestri V, 2 orë - Bachelor
3. Kontrolli Optimal për Sistemet Lineare (Z) - Semestri III, 2 orë

Semestri Veror

1. Deep Learning-Metodat e Aplikimit (O) - Semestri II, 2 orë
2. Teoria dhe Metodologjia e Shkencës me Aplikacione (O) - Semestri IV, 2 orë
3. Përpunimi i Komunikimit me Audio (Z) - Semestri IV, 2 orë

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuara (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës);

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregulloren Nr.01/1328 dt.26.06.2024 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe të universitetit.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet nga data 30.07.2024 deri më 14.08.2024 në orën 16.00.

Kërkesa protokollohet në zyrën e arkivës AZ/04.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "POPI Barbershop" SH.P.K. me seli në Gjilan, Pronar Engjull Ahmeti ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812087204 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "POPI Barbershop" D.O.O. Gjilan, Engjull Ahmeti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812087204 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "POPI Barbershop" L.L.C. with headquarters Gjilan, Engjull Ahmeti has come to the decision to quit its business: 812087204 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEK" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref.nr. 01/1559 Dt. 29/07 2024

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan si dhe nenit 11 të Rregullorës për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/1328 datë 26.06.2024, në mbledhjen XV të mbajtur më datë 25.07.2024, Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, vendosi të shpall:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për këto Fakultete:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Edukimi gjithëpërfshirës, Vështirësitë në të nxënit (programi Arsimit Parashkollor); Arsimi gjithëpërfshirës (master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor; Praktika pedagogjike IV (programi Arsimit Fillor); Edukimi në fëmijërinë e hershme (Programi Parashkollor (Z); Vlerësimi në arsim (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).

II. FAKULTETI JURIDIK

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

(O) E drejta e procedurës penale – Pjesa e posaçme; (O) E drejta e krahësuar; (O) Praktika Profesionale; (Z) Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale; (Z) Etika ligjorë dhe profesionale dhe (Z) Psikologjia gjyqësorë.

III. FAKULTETI EKONOMIK

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Aftësi të shkrimit në biznes (MMSH) Aftësi të shkrimit në biznes (FKA), Përgjegjësia Sociale e Korporatave, Komunikimi në biznes, Sistemi i Menaxhimit të Bazës së të Dhënave me plotësim të normës në FSHK për Shkrim Akademik.

IV. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

I. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha e Shkencave Kompjuterike në nivelin Master: E-Qeverisja:

Semestri Dimëror

1. Informatika Sociale (Z) - Semestri I, 2 orë
2. Arkivimi digjital dhe sistemet e informimit (O) - Semestri III, 2 orë
3. Programet aplikative në E-Qeverisje (O) - Semestri III, 2 orë

Semestri Veror

1. Programimi dhe E-Qeverisja (O) - Semestri II, 2 orë
2. Databaza për E-Qeverisja (O) - Semestri II, 2 orë
3. Zhvillimet në Cloud (Z) - Semestri II, 2 orë

II. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha e Shkencave Kompjuterike në nivelin Master: Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificiale (SKIA):

Semestri Dimëror

1. Sistemet Matëse dhe Metrika (O) - Semestri III, 2 orë
2. Sistemet e bazuara në sensorë (O) - Semestri III, 2 orë
3. Mekatronikë (Z) - Semestri I, 2 orë

Semestri Veror

1. Sensorët dhe Elektronika (O) - Semestri II, 3 orë
2. Automatizimi Industrial dhe Inteligenca Artificiale (O) - Semestri IV, 3 orë

III. Një mësimdhënës për lëndët nga fusha e Shkencave Kompjuterike në nivelin Master: Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificiale (SKIA):

Semestri Dimëror

1. Teoria e Kontrollës dhe Praktika (O) - Semestri I, 2 orë
2. Përpunimi Digjital i Sinjaleve (O) - Semestri V, 2 orë - Bachelor
3. Kontrolli Optimal për Sistemet Lineare (Z) - Semestri III, 2 orë

Semestri Veror

1. Deep Learning-Metodat e Aplikimit (O) - Semestri II, 2 orë
2. Teoria dhe Metodologjia e Shkencës me Aplikacione (O) - Semestri IV, 2 orë
3. Përpunimi i Komunikimit me Audio (Z) - Semestri IV, 2 orë

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuara (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës);

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA-%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregulloren Nr.01/1328 dt.26.06.2024 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe të universitetit.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet nga data 30.07.2024 deri më 14.08.2024 në orën 16.00.

Kërkesa protokollohet në zyrën e arkivës AZ/04.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Agro Invent" D.O.O. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810535297 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Agro Invent" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810535297 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Agro Invent" D.O.O. has come to the decision to quit its business: 810535297 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

